



**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Ombudspersonit • Ombudsperson Institucija • Ombudsperson Institution**

4 prill 2008

Z. Mahir Yagcilar, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

A. nr. 91/2008

Maliq Berisha dhe të tjerët

I nderuari z. Yagcilar,

Me anë të kësaj letre, dëshiroj të tërheqë vëmendjen tuaj në ankesën e z. Maliq Berishës i cili tek Institucioni i Ombudspersonit parashtror ankesën në emër të bashkëfshatarëve të tij nga Lagja e Berishajve të fshatit Grabovc i Ulët i Komunës së Fushë Kosovës, e që ka të bëjë me pohimet për shkeljen e dispozitave të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Mbrojtjen e Mjedisit i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/9 në fuqi nga data 16 Janar 2003 (më tej Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit) si dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (më tej “Konventa”).

Nga ankesa e parashtruar kuptohet se ankuesit ankohen për shkak të mosveprimit të organeve kompetente, sipas kërkesës së parashtruar nga banorët e fshatit Grabovc i Ulët, për të parandaluar pasojat e dëmshme që janë duke iu shkaktuar atyre si pasojë e fillimit të punëve të Korporatës Energjetike të Kosovës (më tej KEK-u) në mihjen sipërfaqësore të dheut me qëllim të nxjerrjes së linjtit nga kjo trevë. Vendi ku kanë filluar punimet e mihjes së dheut është vetëm 50 metra larg shtëpive të banimit të këtij fshati, gjë që seriozisht rrezikon jetën e fshatarëve nga rrëshqitja e dheut. Po ashtu, shqetësimet e tyre konsistojnë edhe në atë se si pasojë e kryerjes së këtyre punimeve krijohet një zhurmë e madhe nga eskavatorët, ndotja e madhe e ujit nëpër puset e shtëpive nga të cilët furnizohen duke e bërë kështu të papërdorshëm për pije, ndotja e ajrit në të gjithë ambientin përreth, duke penguar kështu banorët që të gëzojnë të drejtën e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare, e drejtë e cila garantohet edhe me nenin 8 të Konventës.

Bazuar në raportin e Institutit “INKOS” sh.a., të përpiluar në gusht 2007, e që ka të bëjë me monitorimin e ajrit, ujit dhe zhurmës në zonën e Sibovcit jug-perëndim, janë evidentuar: ndotje e ajrit nga pluhuri më shumë se vlera e lejuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë e që paraqet rrezik për shëndetin publik; ndotje e ujit në shkallë të lartë ashtu që nuk mund të përdoret për pije dhe as për nevoja të tjera familjare; niveli i zhurmës gjatë kohës kur punojnë makinat tejkalon vlerat e lejuara të standardeve të BE.

Duke iu referuar nenit 5 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit, ndër të tjera thuhet “[...]autoriteti publik [...] do t’i ushtrojë detyrat në bazë të parimeve udhëzuese të politikës në vijim, por megjithatë që marrin në konsiderim një evaluim real të [...] (ii) ndërhyrjes së mundshme negative të qëllimit për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

(b) [...] Të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit, standardet dhe aktivitetet do të projektohen dhe implementohen në mënyrë që të: (i) balancohen objektivat e mbrojtjes së mjedisit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik [...].”

Më tej, në nenin 8 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit së lartpërmendur ndër të tjera thuhet “1. Plani hapësinor i Kosovës, Plani hapësinor i komunave, planet për menaxhimin e resurseve natyrore dhe planet e programet e zhvillimit të përcaktuara me ligj, të cilat kanë ndikim në mjedis duhet patjetër të përfshijnë vlerësim të aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimin e tyre mbi mjedisin. Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimi i tyre në mjedis përgatitet dhe paraqitet në mënyrën dhe procedurën e paraparë me ligj dhe evaluimin e ndikimeve pozitive ekonomike të mundshme në aktivitetet e tilla. [...]3. Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara përfshinë analizimin e gjendjes aktuale të mjedisit, ndikimit të mundshëm në mjedis të aktiviteteve të planifikuara , veprimet e propozuara për zbutjen e tij si dhe zhvillimin ekonomik. 4. Plani hapësinor i Kosovës , Planet hapësinore rajonale, Planet hapësinore komunale si dhe aktet e tjera të planifikimit dhe rregullimit hapësinor , para aprovimit të tyre, i paraqiten për vlerësim (dhënie të mendimit profesional) Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, që është nën autoritetin e Ministrisë”.

MMPH dhe komuna e Fushë Kosovës kanë qenë të njoftuara për problemet e lartshënuara qysh me fillimin e punëve në mihjen e Sibovcit, gjatë vitit 2007, kur fshatarët i janë drejtuar me peticion lidhur me problemet e lartpërmendura. Pas ankesës së parashtruar nga ana e banorëve të fshatit drejtuar Institucionit të Ombudspersonit në shkurt 2008, në më 12 shkurt 2008 vizitua fshatin Grabovc i Ulët për të parë gjendjen nga afër dhe konstatua se nëse nuk ndërmerren masa urgjente për sigurimin e mirëqenies dhe të drejtës për banim për banorët e këtij fshati, pasojat mund të jenë tragjike për shëndetin e tyre. Gjithashtu menjëherë pas vizitës kemi dhënë deklaratë për media duke njoftuar kështu opinionin e gjerë dhe në radhë të parë për të tërhequr vëmendjen e organeve përgjegjëse në lidhje me shkeljen e së drejtës për banim të banorëve të fshatit në fjalë. Mirëpo, siç duket, autoritetet kompetente kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre për të zgjidhur çështjen e banorëve. Nga faktet e lartpërmendura dhe në bazë të hetimeve tona nuk duket se organet kompetente kanë marrë parasysh problemet që do t’u shkaktohen banorëve të fshatit Grabovc i Ulët me fillimin e punimeve të lartpërmendura, ashtu siç kanë qenë edhe të obliguar të veprojnë në bazë të ligjeve të aplikueshme.

Rasti konkret gjithashtu ngritë çështjen e shkeljes së nenit 8 të Konventës Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më tej “Konventa”) që mbron të drejtën e individëve

për respektimin e jetës private dhe familjare. Neni 8 i Konventës thotë “1. Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij; 2. Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.”

Ashtu siç edhe është konfirmuar nga aktgjykimet e përmendura më poshtë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, obligimi i shtetit sipas nenit 8 të Konventës përfshinë gjithashtu obligimin e autoriteteve publike për të mbrojtur individët nga ndërhyrja e ndonjë pale të tretë në të drejtën e tyre në jetën private dhe familjare (shih, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 19 shkurt 1998, *López Ostra kundër Spanjës*, aktgjykimi i datës 9 dhjetor 1994, *Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 21 shkurt 1990 dhe *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 2 tetor 2001). Kjo përfshinë obligimin e autoriteteve publike që të ndërhyjnë në mbrojtjen e të drejtave të individëve që të gëzojnë të drejtën e tyre në jetën private dhe familjare, e sidomos në rastet kur është në pyetje rrezikimi i shëndetit të tyre.

Në rastin konkret, nga faktet e prezantuara më lartë mund të vlerësohet nëse autoritetet publike kanë vepruar në mënyrë të duhur apo jo. Për këtë arsye, ne përsëri vëmë në dukje faktin se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (më tej MMPH) dhe autoritetet komunale të Komunës së Fushë Kosovës kanë injoruar gjendjen në rastin konkret edhe pas ankesave të qytetarëve.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura më lart, ku rezultojnë të provuara shkelje të dispozitave të lartcekura të Ligjit mbi mbrojtjen e Mjedisit dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, ne kërkojmë përmirësimin e gjendjes konform standardeve të kërkuara.

Për këtë qëllim, e në pajtim me nenin 4.1.(e),(g) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë,

REKOMANDOJMË

- Të ndërmerren masat e menjëhershme për gjetjen e një zgjidhjeje për banorët e fshatit Grabovc i Ulët, ashtu që, në pamundësi të marrjes së masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe uljes së nivelit të zhurmës, si masë e fundit të shqyrtohet mundësia e zhvendosjes së familjeve të dëmtuara dhe kompensimi i pronave të tyre
- në pajtim me nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Ju lutemi që të na njoftoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi brenda 30 ditësh, në pajtim me nenin 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

Kopja u dërgohet: z. Hashim Thaqi, Kryeministër i Republikës së Kosovës
z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë
zj. Justina Shiroka-Pula, Ministre e Energjisë dhe Minierave
z. Astrit Beqa, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave
z. Muhamet Aliu, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
z. Ilir Morina, Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
z. Remzi Shahini, Drejtor Menaxhues i sh.a. KEK
z. Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës
z. Ismet Beqiri, Kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Republikës së Kosovës
zj. Shpresa Sheremeti, Koordinatore në Njësinë për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor